



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

**RREGULLORE (ZKM) NR. 07/2026 PËR PLOTËSIMIN DHE
NDRYSHIMIN E RREGULLORES (ZKM) –NR. 01/2020 PËR
ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE
TË PUNËS NË ZYRËN E KRYEMINISTRIT¹**

¹ Rregullore (ZKM) Nr. 07/2026 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores (ZKM) – Nr. 01/2020 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Zyrën e Kryeministrit, miratuar me Vendimin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës Nr.087/2026, të datës 23.04.2026.

Kryeministri i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 94 (3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 19 (5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15 (3) dhe 28 (3) të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura dhe nenit 2 (2) dhe 9 (7) të Rregullores (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura,

Nxjerr:

RREGULLORE (ZKM) NR. 07/2026 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES (ZKM) –NR. 01/2020 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË ZYRËN E KRYEMINISTRIT

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rrregulloreje është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores (ZKM) Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit.

Neni 2

Në nenin 6, paragrafin 1 pas nënparagrafit 1.5 të Rregullores bazë shtohet nënparagrafi 1.5A me tekstin si në vijim:

1.5A. Zyra për Kontrollin dhe Harmonizimin Gjuhësor (**ZKHGJ**):

1.5A.1 Divizioni për Kontrollin Gjuhësor;

1.5A.2. Divizioni për Harmonizimin Gjuhësor.

Neni 3

Pas nenit 26 të Rregullores bazë shtohen nenet si në vijim:

Neni 26A

Zyra për Kontrollin dhe Harmonizimin Gjuhësor

1. Zyra për Kontrollin dhe Harmonizimin Gjuhësor është njësi organizative në kuadër të Zyrës së Kryeministrit e cila ka për mision kontrollin e cilësisë dhe sigurimin e pajtueshmërisë gjuhësore të dokumenteve të cilat dërgohen për miratim në Mbledhje të Qeverisë.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës për Kontrollin dhe Harmonizimin Gjuhësor janë:

2.1 Harmonizimin e konsistencës gjuhësore të propozimeve të dërguara për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Qeverisë, funksion i cili përfshin ndër të tjera: kontrollin e konsistencës ndërmjet versionit gjuhësor në të cilin është hartuar dokumenti/akti dhe atij të përkthyer, garantimin që terminologjia e shfrytëzuar në versionin e përkthyer është e njëjtë me atë të shfrytëzuar në aktet e ngjashme të përkthyer, mbrojtjen e parimit të unifikimit të gjuhës juridike të shfrytëzuar në versionet e përkthyer të akteve/dokumenteve.

2.2. Kontrollimin e cilësisë, dhe në rast të mangësive evidente në përkthim, kthimin prapa të propozimit të organi propozues për përmirësim, funksion i cili përfshin ndër të tjera: kontrollin e rregullsisë sintaksore të gjuhës së shfrytëzuar në dokumentin e përkthyer, kontrollin e saktësisë së terminologjisë së shfrytëzuar, dhënien e garancionit që kuptimi në gjuhët zyrtare është i njëjtë/barabartë, ndërhyrjen në draft për ta përmirësuar gjuhën dhe për të dhënë rezultatin e një dokumenti që është i përkthyer në mënyrë cilësore.

2.3. Në rast të mangësive të evitueshme, përmirësimin gjuhësor të propozimit, njoftimin e organi propozues me versionin final të përmirësuar të propozimit, me qëllim që i njëjti të procedohet për shqyrtim dhe miratim në Mbledhje të Qeverisë, funksion i cili përfshin ndër të tjera: ndërhyrjen direkte në dokument, në një formë të ndryshimeve me formatin track-change, ofrimin e një dokumenti final, të ndryshuar i cili është i gatshëm për tu miratuar në Qeveri, njoftimin e akterëve hartues mbi këtë ndryshim dhe dhënien e mundësisë atyre për të reaguar nëse vërejnë një defekt madhor.

2.4. Krijimin e terminologjisë standarde, funksion i cili përfshin ndër të tjera: zhvillimin e terminologjisë së unifikuar, dhe ruajtjen e asaj në një dokument të integruar ku kanë qasje të gjitha njësitë përgjegjëse të përkthimit dhe publiku i gjerë, kodifikimin e terminologjisë, ndërlidhjen e termeve me fjalorët terminologjik juridik.

2.5. Krijimin e infrastrukturës së nevojshme teknike, funksion i cili përfshin ndër të tjera: digjitalizimin e procesit të harmonizimit dhe kontrollit gjuhësor, shfrytëzimin e inteligjences artificiale në lehtësimin e procesit të harmonizimit dhe kontrollit gjuhësor dhe hartimin e fjalorëve zyrtar të nevojshëm për përdorim në njësitë përkthyes të institucioneve publike.

2.6. Bashkëpunimin me Zyrën e Komisionerit të Gjuhëve për të avancuar përdorimin e gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës;

2.7. Koordinimin e aktiviteteve me njësitë përgjegjëse të përkthimeve në ZKM dhe në ministri, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së përkthimeve si dhe harmonizimit gjuhësor të dokumenteve si dhe të krijimit të terminologjisë gjuhësore standarde;

2.8. Koordinimin e aktiviteteve me Zyrën Ligjore në ZKM me qëllim të standardizimit të terminologjisë juridike të përdorur në dokumentet qeveritare;

2.9. Lëshimin e Deklaratës për lekturim dhe harmonizim gjuhësor për të gjitha propozimet si pjesë e pakos së dokumenteve, para miratimit të tyre në Mbledhje të Qeverisë.

3. Drejtori i Zyrës për Kontrollin dhe Harmonizimin Gjuhësor i raporton dhe i përgjigjet Sekretarit të Përgjithshëm.

4. Në kuadër të Zyrës për Kontrollin dhe Harmonizimin Gjuhësor bëjnë pjesë divizionet si në vijim:

4.1. Divizioni për Kontrollin Gjuhësor; dhe

4.2. Divizioni për Harmonizimin Gjuhësor.

5. Numri i të punësuarve në Zyrën për Kontrollin dhe Harmonizimin Gjuhësor është dhjetë (10).

Neni 26B **Divizioni për Kontrollin Gjuhësor**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Kontrollin Gjuhësor janë:

1.1. Kontrollimin e cilësisë, dhe në rast të mangësive evidente në përkthim, kthimin prapa të propozimit të organi propozues për përmirësim, funksion i cili përfshin ndër të tjera: kontrollin e rregullsisë sintaksore të gjuhës së shfrytëzuar në dokumentin e përkthyer, kontrollin e saktësisë së terminologjisë së shfrytëzuar, dhënien e garancionit që kuptimi në gjuhët zyrtare është i njëjtë/barabartë, ndërhyrjen në draft për ta përmirësuar gjuhën dhe për të dhënë rezultatin e një dokumenti që është i përkthyer në mënyrë cilësore.

1.2. Në rast të mangësive të evitueshme, përmirësimin gjuhësor të propozimit, njoftimin e organit propozues me versionin final të përmirësuar të propozimit, me qëllim që i njehti të procedohet për shqyrtim dhe miratim në Mbledhje të Qeverisë, funksion i cili përfshin ndër të tjera: ndërhyrjen direkte në dokument, në një formë të ndryshimeve me formatin track-change, ofrimin e një dokumenti final, të ndryshuar i cili është i gatshëm për tu miratuar në Qeveri, njoftimin e akterëve hartues mbi këtë ndryshim dhe dhënien e mundësisë atyre për të reaguar nëse vërejnë një defekt madhor;

1.3. Lëshimin e Deklaratës për lekturim dhe harmonizim gjuhësor për të gjitha propozimet si pjesë e pakos së dokumenteve, para miratimit të tyre në Mbledhje të Qeverisë.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Kontrollin Gjuhësor raporton te Drejtori i Zyrës.

3. Numri i të punësuarve në kuadër të Divizionit për Kontrollin Gjuhësor është pesë (5).

Neni 26C **Divizioni për Harmonizimin Gjuhësor**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Harmonizimin Gjuhësor janë:

1.1. Harmonizimin e konsistencës gjuhësore të propozimeve të dërguara për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Qeverisë, funksion i cili përfshin ndër të tjera: kontrollin e konsistencës ndërmjet versionit gjuhësor në të cilin është hartuar dokumenti/akti dhe atij të përkthyer, garantimin që terminologjia e shfrytëzuar në versionin e përkthyer është e njëjtë me atë të shfrytëzuar në aktet e ngjashme të përkthyer, mbrojtjen e parimit të unifikimit të gjuhës juridike të shfrytëzuar në versionet e përkthyer të akteve/dokumenteve.

1.2. Krijimin e terminologjisë standarde, funksion i cili përfshin ndër të tjera: zhvillimin e terminologjisë së unifikuar, dhe ruajtjen e asaj në një dokument të integruar ku kanë qasje të gjitha njësitë përgjegjëse të përkthimit dhe publiku i gjerë, kodifikimin e terminologjisë, ndërlihdjen e termeve me fjalorët terminologjik juridik.

1.3. Krijimin e infrastrukturës së nevojshme teknike, funksion i cili përfshin ndër të tjera: digjitalizimin e procesit të harmonizimit dhe kontrollit gjuhësor, shfrytëzimin e inteligjences artificiale në lehtësimin e procesit të harmonizimit dhe kontrollit gjuhësor dhe hartimin e fjalorëve zyrtar të nevojshëm për përdorim në njësitë përkthyes të institucioneve publike.

1.4. Bashkëpunimin me Zyrën e Komisionerit të Gjuhëve për të avancuar përdorimin e gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës;

1.5. Koordinimin e aktiviteteve me njësitë përgjegjëse të përkthimeve në ZKM dhe në ministri, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së përkthimeve si dhe harmonizimit gjuhësor të dokumenteve si dhe të krijimit të terminologjisë gjuhësore standarde;

1.6. Koordinimin e aktiviteteve me Zyrën Ligjore në ZKM me qëllim të standardizimit të terminologjisë juridike të përdorur në dokumentet qeveritare.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Harmonizimin Gjuhësor raporton te Drejtori i Zyrës.

3. Numri i të punësuarve në kuadër të Divizionit për Harmonizimin Gjuhësor është katër (4).

Neni 4 Shtojca e Rregullores

Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është Shtojca I, e cila përmban numrin e përgjithshëm të të gjithë të punësuarve në Zyrën për Kontrollin dhe Harmonizimin Gjuhësor dhe numrin e veçantë për secilën njësi.

Neni 5 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

23 prill 2026

SHTOJCA I: TABELA

ORGANOGRAMI I ZYRËS			
Numri i përgjithshëm i të punësuarve			
POZITA/STRUKTURA	Klasa	Grupi (i përgjithshëm ose i veçantë)	Numri i përgjithshëm i të punësuarve
1.5 A Zyra për Kontrollin dhe Harmonizimin Gjuhësor			10
Drejtori i Zyrës për Kontrollin dhe Harmonizimin Gjuhësor	Drejtues i mesëm	N/A	1
1.5A.1. Divizioni për Kontrollin Gjuhësor			
Udhëheqës i Divizionit për Kontrollin Gjuhësor	Drejtues i ulët	N/A	1
Zyrtar i lartë për përkthim	Profesional 1	Grupi i përkthimit dhe Interpretimit	4
1.5A.2. Divizioni për Harmonizimin Gjuhësor			
Udhëheqës i Divizionit për Harmonizimin Gjuhësor	Drejtues i ulët	N/A	1
Zyrtar i lartë për përkthim	Profesional 1	Grupi i përkthimit dhe Interpretimit	3